



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, 14 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me date 30.07. 2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale që gjinden në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve të paraqitura në tabelën si në vijim:

Nr.	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m ²
1	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00559-4	Babush i Muhaxherëve	16132
2	P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00555-2	Babush i Muhaxherëve	3868

Neni 2

Sipas nenit 1 të këtij Vendimi pronat komunale ipen në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh nëpërmjet Njoftimit publik. Pronat e cekura në nenin 1 të këtij vendimi janë publikuar brenda afatit ligjor në faqen zyrtare të komunës sipas aktit të Kryetarit të Komunës 1Nr.463-62822 datë

18.09.2019 konformë dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 si prona të lira për dhënien në shfrytëzim.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale është investimi në biznese prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 4

Procedurën e Njoftimit publik e zbaton Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, në bazë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatgjatë në afat prej 99 vitesh.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr.15- 463-32604

Lipjan, më 30.07.2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

